



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 334

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTit
VETËDEKLARUES Z. PASHK GJERGJ GJETAJ, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK,
I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT", PËR BASHKINË
PUKË

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Pashk Gjergj Gjetaj, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit" për Bashkinë Pukë.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

Data: 12.4.2023 Nr: 334
Ora: 12:00



Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Pashk Gjergj Gjetaj, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Lëvizja e Legalitetit" për Bashkinë Pukë.

emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Pashk Gjergj Gjetaj, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak të Bashkisë Pukë, i mbështetur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”.

Për këtë kandidat në datën 31.3.2023, pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik SHK-PLL-13440. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Pashk Gjergj Gjetaj, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, se është marrë masë dëbimi nga shteti Grek në Selanik, për shkelje të paligjshme të kufirit në vitin 1994. Në vitin 1995 është marrë masë dëbimi po nga shteti Grek në qytetin e Selanikut , për kalim të paligjshëm të kufirit. Në vitin 1996 është marrë masë dëbimi ne shtetin Grek ne Kozan, për kalim të paligjshëm;
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se një muaj ?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, duke deklaruar se ka qëndruar për arsye ekonomike në Vasikuak të Selanikut , të shtetit Grek, nga viti 1992-1995, me adresë “Vasilika, Parashqevi, Soroti në shtetin Grek”;

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Pashk Gjergj Gjetaj kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” për Bashkinë Pukë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI